2. Studiuesi duhet të zbatojë parashikimet e ligjit nr.45/2015, i ndryshuar dhe udhëzuesit për studiues/media, “Bashkëlidhur kërkesës të vendoset projekti, vendi, institucioni që do të bëjë publikimin dhe afati kohor i realizimit; (pika 2.4. e Udhëzuesit: - Projekti kërkimor i paraqitur duhet të ketë një temë të qartë dhe të përmbajë të dhëna të arsyeshme që kanë lidhje me qasjen politike dhe historike të veprimtarisë së ish Sigurimit të Shtetit, si mekanizëm në shërbim të ruajtjes së pushtetit nga Partia e Punës së Shqipërisë);
3. Ky vendim është i ankimueshëm sipas legjislacionit në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Kryetare: Dr. Gentiana Sula

Anëtarë: Dr. Albert Nikolla Altin Hoxha, Gjergj Marku, Skënder Vrioni



VENDIME

TË ORGANIZIMIT TË BRENDSHËM
TË AUTORITETIT

Vendim nr. 32, datë 23.01.2023 (i shkurtuar)

Në mbështetje të Ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” (i ndryshuar), Neni 36, pika 6 “Autoriteti për realizimin e veprimtarisë sipas këtij ligji, ka të drejtë të përzgjedhë dhe të kontrakttojë ekspertë të jashtëm” dhe VKM nr. 187, datë 8.03.2017, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike” dhe Vendim i Autoritetit nr. 424, datë 27.09.2022 “Për procedurën që ndiqet për kontraktimin e ekspertëve/këshilltarëve vendas apo ndërkombëtarë”, si dhe Urdhrit të Brendshëm të Kryetares së Autoritetit me nr. 200, datë 3.11.2022,

V E N D O S I:

1. Të miratojë termat e referencës për Ekspert/këshilltar për procesin e reflektimit dhe përditësimit (ndryshimeve shtesave) të akteve themelore nënligjore të Autoritetit për Informim, në kuadër të ndryshimeve të reja ligjore të Ligjit 45/2015, me ligjin Nr. 72, datë 20.10.2022., bashkëlidhur këtij vendimi);
2. Të shpallë në faqen zyrtare të institucionit, njoftimin për pozicionin e ekspertit/këshilltarit, vlerësimi dhe përzgjedhja e të cilit do të bëhet nga Komisioni vlerësues, i caktuar me Urdhër të brendshëm të Kryetarit të Autoritetit;
3. Të kontrakttojë kandidatin fitues, pagesa e të cilit do të bëhet sipas parashikimeve të VKM nr. 178, datë 08.03.2017, në masën e përcaktuar. Pagesa e Ekspertit/Këshilltarit do të mbulohet plotësisht nga buxheti i Autoritetit;
4. Ngarkohet Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Arkiv Protokollit për kontraktimin dhe likuidimin e pagesës së ekspertit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare: Dr. Gentiana Sula

Anëtarë: Dr. Albert Nikolla Altin Hoxha, Gjergj Marku, Skënder Vrioni

Vendim nr. 33, datë 23.01.2023 (i shkurtuar)

Ligji nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, neni 17 i Rregullores “Për Organizimin dhe funksionimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-sigurimit të Shtetit”, Vendimi Nr.26/2022, datë 17.3.2022, “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit Nr.95/2016, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimin e pagave të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”, Ligjin Nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”

V E N D O S I:

1. Miratimin e planit të ri të rekrutimeve dhe prioriteteve për vitin 2023, sipas tabelës së mësipërme pjesë e këtij vendimi.
2. Plani shtesë i rekrutimeve të Autoritetit i dërgohet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Institucioneve përkatëse sipas ligjit nr. 152 datë 30.05.2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe VKM-së nr. 108/2014, “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”.
3. Ngarkohet Sekretariati Teknik për zbatimin e këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare: Dr. Gentiana Sula

Anëtarë: Dr. Albert Nikolla Altin Hoxha, Gjergj Marku, Skënder Vrioni



BIBLIOGRAFIA

E INFORMACIONIT
TË DEKLASIFIKUAR NË AIDSSH

VENDIM NR. 1, DATË 15.01.2023 (I SHKURTUAR)

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, i ndryshuar, kreu III, neni 13, pika b), dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 662, datë 15.11.2017 “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, kreu III, neni 4, pika a), c), Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr. 13, datë 03.05.2018, të Kryetares së Autoritetit “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e plotë të dosjeve të klasifikuara “sekret shtetëror”, me Vendimin nr. 1, datë 15.01.2023, si më poshtë:

Fondi arkivor i ish-Sigurimit të Shtetit që administrohet nga AIDSSH

I Deklasifikimin e plotë të informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror” që gjendet në:

1. Dosje personale nr. 360, në ngarkim të A. M., me 24 (njëzet e katër) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1963-1973. Dosja i përket Fondit ish Operativ.
2. Dosje formulare nr. 1099, në ngarkim të Xh. K., me 49 (dyzet e nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1977-1979. Dosja i përket Fondit ish Operativ.
3. Dosje formulare nr. 1363, në ngarkim të Xh. K., me 106 (njëqind e gjashtë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1967-1979. Dosja i përket Fondit ish Operativ.
4. Kartelë Model 2 nr. 519, në ngarkim të N. B., me 1 (një) fletë. Niveli i klasifikimit të kartelës është “Tepër Sekret”. Kartela daton në vitin 1967. Kartela i përket Fondit ish Dega IV.
5. Kartelë Model 2, në ngarkim të F. N., me 1 (një) fletë. Niveli i klasifikimit të kartelës është “Tepër Sekret”. Kartela daton në vitin 1952. Kartela i përket Fondit ish Dega IV.
6. Dosje e problemit të centralizuar “Gorilla” nr. 978, me 6 vëllime me 1776 (njëmijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dokumentet në dosje datojnë deri në vitet 1981-1986. Dosja i përket Fondit ish Dega IV.
7. Fashikulli “Renegati” nr. 295, me 398 (treqind e nëntëdhjetë e tetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”. Dokumentet në dosje datojnë në vitet 1974 - 1987. Dosja i përket Fondit ish Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.
8. Lista e veçimit nr. 1 dt.16.12.1990 dhe vendim për heqjen nga kontrolli operativ 2/B dhe asgjësimi i dosjes formulare nr. 8585 në ngarkim të H. C., me 3 (tre) fletë. Niveli i klasifikimit të dokumenteve është “Sekret”. Dokumentet datojnë në vitet 1989 - 1990. Dokumentet i përkasin Fondit ish Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.
9. Dosje fashikullore nr. 21 me procese të të arratisurve Shqiptarë dhe të dërguar nga shteti armik, me 23 (njëzet e tre) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dokumentet në dosje datojnë në vitet 1962 - 1966. Dosja i përket Fondit ish Dega e Punëve të Brendshme Pogradec.
10. Kartelë Model 2 nr. 516/692, në ngarkim të Sh. S., me 1 (një) fletë. Niveli i klasifikimit të kartelës është “Tepër Sekret”. Kartela daton në vitin 1958. Kartela i përket Fondit ish Dega IV.
11. Dosje formulare nr. 105, në ngarkim të Sh. S., me 123 (njëqind e njëzet e tre) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1962-1987. Dosja i përket Fondit ish Operativ.
12. Dosje formulare nr. 7937, në ngarkim të Ll. K., me 81 (tetëdhjetë e një) fletë dhe 6 (gjashtë) fletë në zarf. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1963-1989. Dosja i përket Fondit ish Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.
13. Dosja nr.347 “Për disa komente e propagandën armiqësore që bëhen në ushtri lidhur me situatën aktuale dhe ngjarjet në Evropën Lindore”, me 107 (njëqind e shtatë) fletë. Dokumentet datojnë në

vitin 1990. Niveli i klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondi nr.4, Drejtoria e I.

14. Dosja nr.558 “Mbi hyrjet e paligjshme në ambasada në Tiranë”, me 4 (katër) fletë. Dokumentet datojnë në vitin 1990. Niveli i klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondi nr.4, Drejtoria e I.

II Deklasifikimin pjesërisht të informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror” që gjendet në:

1. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Tiranë, fletë regjistri i Regjistrit të Agjenturës nr.2, konkretisht rreshti me nr. rendor 1396, në ngarkim të F. F., me 2 (dy) fletë. Niveli i klasifikimit të regjistrit është “Tepër Sekret”.

KRYETARE E KDZH-së

Gentiana Sula

VENDIM NR. 2, DATË 23.01.2023 (I SHKURTUAR)

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, i ndryshuar, kreu III, neni 13, pika b), dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 662, datë 15.11.2017 “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, kreu III, neni 4, pika a), c), Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr. 13, datë 03.05.2018, të Kryetares së Autoritetit “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e plotë të dosjeve të klasifikuara “sekret shtetëror”, me Vendimin nr. 2, datë 23.01.2023, si më poshtë:

Fondi arkivor i ish-Sigurimit të Shtetit që administrohet nga AIDSSH

I Deklasifikimin e plotë të dosjeve:

1. Dosje personale dhe pune nr. 10546, në ngarkim të A.T., respektivisht me 34 (tridhjetë e katër) fletë dhe 42 (dyzet e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1978-1990. Dosja i përket Fondit ish Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.
2. Libër evidencë agjenturale-operative e punëtorit operativ nr. 66, me 114 (njëqind e katërmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit është “Tepër Sekret”. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1970-1978. Dokumenti i përket Fondit ish Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.
3. Kartelë model 2, nr. 8574/20692, në ngarkim të A.H.. Niveli i klasifikimit është “Tepër Sekret”. Kartela daton në vitet 1975-1980. Kartela i përket fondit Ish Dega IV.
4. Kartelë model 2, nr. 2146, në ngarkim të I.A.. Niveli i klasifikimit është “Tepër Sekret”. Kartela daton në vitet 1977-1980. Kartela i përket fondit Ish Dega IV.
5. Kartelë model 2, nr. 4071, në ngarkim të J. Z.. Niveli i klasifikimit është “Tepër Sekret”. Kartela daton në vitet 1978-1981. Kartela i përket fondit Ish Dega IV.
6. Kartelë model 2, nr. 6646, në ngarkim të P. M.. Niveli i klasifikimit është “Tepër Sekret”. Kartela daton në vitet 1973-1986. Kartela i përket fondit Ish Dega IV.
7. Kartelë model 2, nr. 1854, në ngarkim të S. L.. Niveli i klasifikimit është “Tepër Sekret”. Kartela daton në vitet 1969-1979. Kartela i përket fondit Ish Dega IV.
8. Kartelë model 2, nr. 2404, në ngarkim të K.Q.. Niveli i klasifikimit është “Tepër Sekret”. Kartela daton në vitet 1970-1975. Kartela i përket fondit Ish Dega IV.

9. Kartelë model 2, nr. 1851, në ngarkim të Xh. E.. Niveli i klasifikimit është “Tepër Sekret”. Kartela daton në vitet 1969-1977. Kartela i përket fondit Ish Dega IV.
10. Kartelë model 2, nr. 2111, në ngarkim të H.M.. Niveli i klasifikimit është “Tepër Sekret”. Kartela daton në vitet 1972-1974. Kartela i përket fondit Ish Dega IV.
11. Kartelë model 2, nr. 8000, në ngarkim të M.M.. Niveli i klasifikimit është “Tepër Sekret”. Kartela daton në vitet 1985-1987. Kartela i përket fondit Ish Dega IV.
12. Dosje personale nr. 6207, në ngarkim të Dh. S., me 60 (gjashtëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1974-1990. Dosja i përket Fondit ish Degës së Punëve të Brendshme Fier.
13. Fashikull mbi emigracionin ekonomik shqiptar në vende të ndryshme të botës, me 81 (tetëdhjetë e një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dokumentet datojnë në vitet 1965-1968. Dosja i përket Fondit ish Drejtoria II-të.
14. Fashikull i veçantë për të arratisurit në shtator të vitit 1990, me 98 (nëntëdhjetë e tetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dokumentet e datojnë në vitin 1990. Dosja i përket Fondit ish Drejtoria II-të.
15. Fashikull i veçantë nr. 173 për të arratisurit, 2 volume përkatësisht me 261 (dyqind e gjashtëdhjetë e një) fletë + 2 fotografi dhe 356 (treqind e pesëdhjetë e gjashtë) fletë + 21 fotografi. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dokumentet e datojnë në vitet 1987-1990. Dosja i përket Fondit ish Drejtoria II-të.
16. Fondi nr.4, Drejtoria e I, Viti 1990, Dosja nr.110 “Mbi refugjatët shqiptarë”, me 4 (katër) fletë. Niveli i klasifikimit është “Sekret”. Dokumentet datojnë në vitin 1990.
17. Fondi nr.4, Drejtoria e I, Viti 1990, Dosja nr.139 “Disa të dhëna dhe informacione të Drejtorisë III-të mbi refugjatët shqiptarë”, me 35 (tridhjetë e pesë) fletë. Niveli i klasifikimit është “Sekret”. Dokumentet datojnë nga vitin 1990-1991.
18. Fondi nr.4, Drejtoria e I, Viti 1990, Dosja nr.118 “Mbi përmbajtjen e letrave të dërguara nga persona të larguar nga vendi ynë nëpërmjet futjes në ambasadave të huaja”, me 8(tetë) fletë. Niveli i klasifikimit është “Sekret”. Dokumentet datojnë në vitin 1990.
19. Fondi nr.4, Drejtoria e I, Viti 1989, Dosja nr.268 “Disa përfundime për punën e bërë dhe masat e marra për zbulimin, parandalimin dhe goditjen e tendencës së arratisjes jashtë shtetit në Degët e Punëve të Brendshme Pogradec, Fier, Shkodër, Krujë dhe Elbasan”, me 34(tridhjetë e katër) fletë.
20. Fondi nr.4, Drejtoria e I, Viti 1981, Dosja nr.90 “Raport mbi disa konkluzione që dalin në liqenin e Pogradecit dhe arratisjet e ndodhura kohët e fundit” me 14(katërmëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit është “Sekret” Dokumentet datojnë në vitin 1981.
21. Fondi nr.4, Drejtoria e I, Viti 1985, Dosja nr.119 “Listat dhe relacionet përkatëse për të arratisurit gjatë viteve 1944-1950 ardhur nga degët e rretheve Ersekë, Tepelenë, Pogradec, Skrapar e Pukë për Degën e I-rë të Drejtorisë së I-rë”, me 145(njëqind e dyzet e pesë) fletë. Niveli i klasifikimit është “Sekret”. Dokumentet datojnë në vitin 1985.
22. Fondi nr.4, Drejtoria e I, Viti 1976, Dosja nr.44 “Informacione dërguar K. Q. P. P. Sh-së mbi arratisjen në Jugosllavi të familjes së K.K.”, me 15(pesëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit është “Sekret”. Dokumentet datojnë në vitin 1976.
23. Indeksi i të arratisurve, nr. 3, grupi II-13, me 151 (njëqind e pesëdhjetë e një) fletë dhe 41 fletë me listë emërore e të arratisurve, fëmijë të tërhequr në arrati, atyre të lindur jashtë shtetit, si dhe grave me kombësi shqiptare e të huajt të martuara me të arratisurit jashtë shtetit. Niveli i klasifikimit është “Tepër Sekret”. Indeksi i përket Fondit ish Dega Punëve të Brendshme Pogradec.

KRYETARE E KDZH-së

Gentiana Sula



VEPRIMTARI

KUJTESA DHE
EDUKIMI QYTETAR

KREU I DELEGACIONIT TË BE-SË, ZNJ. CRISTIANE HOHMAN KREU NJË VIZITË NË AIDSSH DHEMBËSHTET MISIONIN E TIJ MBI ZBARDHJEN E SË SHKUARËS

Më datë 10 .01.2023 kreu i Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri, Znj. Christiane Hohmann zhvilloi një vizitë pune në Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.


Në këtë vizitë znj. Hohmann u prit nga kryetarja dhe anëtarët e Autoritetit, ku u njoh nga afër me punën e institucionit, sfidat e së tashmes e të së ardhmes, dhe me hapësirat e reja ku zhvillon veprimtarinë Autoriteti.



Bashkëpunimi mes AIDSSH dhe BE në projektin për të zhdukurit ishte në qendër të bisedimeve.


Znj. Christiane Hohmann la këtë shënim në librin e përshtypjeve të Autoritetit në të cilin shkruajti: “Faleminderit për punën tuaj kaq thelbësore për të qartësuar memorien e një kohe të rëndësishme të historisë së Shqipërisë. Evropa do të vazhdojë të mbështesë punën tuaj të admirueshme.”

MËSUES TË HISTORISË NGA I GJITHË VENDI MORËN PJESË NË WEBINARIN E RRJETIT NDËRKOMBETAR TË KUJTESËS (ENRS)



Më datë 20 janar rreth 80 mësues të historisë dhe të edukimit qytetar nga Shqipëria morën pjesë në webinar-in e Rrjetit Ndërkombëtar të Kujtesës, (ENRS), me objekt “Burimet e informacionit për mësuesit e historisë, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Përkujtimit të Holokaustit.”

ENRS ka në qendër të misionit të tij nxitjen e dialogut mbi historinë evropiane të shekullit të 20. Në këtë ëebinar një mësuese nga Austria ndau përvojën e saj se çfarë metodash praktike përdorte në drejtim të përkujtimit të një ngjarjeje historike, si dhe aktivitetin që zhvillonte gjatë vizitës studimore në një vend kujtese.



Në funksion të rritjes së aksesit të mësuesve të historisë në këtë webinar, Autoriteti bashkëpunoi me Ministrinë e Arsimit Sporteve dhe Rinisë dhe Shoqatën e Mësuesve të Historisë së Shqipërisë “Rinia dhe Historia”.

“SFIDAT E MËSIMDHËNIES SË HISTORISË DHE RISHQYRTIM I ROLIT TË SHQIPTARËVE NË SHMANGIEN E NDIKIMIT TË HOLOKAUSTIT NË SHQIPËRI DHE KOSOVË

AUTORITETI HAP ARKIVAT PËR HEBRENJTË



Më datë 27 janar 2023 në orën 11:00 në kuadër të vitalizimit të Marrëveshjes ndërinstitucionale me Ministrinë e Arsimit Sporteve dhe Rinisë, nënshkruar më datë 18.03.2021, në Ditën Ndërkombëtare të Përkujtimit të Holokaustit, Autoriteti për Informim mbi Dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit me praninë e trupit diplomatik, partnerëve, përfaqësuesve të Ministrisë së Arsimit, dhe Sportit, mësuesve të historisë dhe edukimit qytetarë, kërkuesve shkencorë dhe medias zhvilluan aktivitetin me temë: “Sfidat e mësimdhënies së historisë dhe rishqyrtim i rolit të shqiptarëve në shmangien e ndikimit të holokaustit në Shqipëri dhe Kosovë”. Me këtë rast u ekspozuan një sërë dokumentesh të krijuar nga ish-Sigurimi i Shtetit për hebrejtë.

Autoriteti së bashku me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit janë angazhuar në realizimin e projekteve të përbashkëta në drejtim edukimit të brezave të rinj mbi ngjarje të së shkuarës sonë komuniste. Autoriteti është në fazën e ndërtimit të një projekti që synon përfshirjen e aktivitetit të ish-Sigurimit të Shtetit në kurrikulat e arsimit parauniversitar. Përmes këtij projekti synohet mundësimi i trajnimeve me mësuesit e këtij target grupi, si edhe grupe të tjera interesi, si ekspertë arsimit, hartues kurrikulash, krijuar tekstesh shkollorë, prindër e mësues. Në kuadër të tij planifikohen vizita në vende të kujtesës, pjesëmarrje në aktivitete në kujtim të ngjarjeve të rëndësishme me fokus kujtesën historike e ndërgjegjësimin e nxënësve për këto ngjarje, realizimin e projekteve në shërbim të kujtesës historike etj.

Marrëdhënia me të vërtetën historike, rëndësia e të njohurit me dokumentet arkivore në mësimdhënien e historisë; Kontributi i shqiptarëve etnikë për shpëtimin e hebrenjve nga Holokausti; si dhe Qëndrimi i shtetit shqiptar, nën dritën e dokumenteve arkivore mbi riatdhesimin e hebrenjve në fillim të viteve 90-të, në dosjet që ish-Sigurimi i Shtetit, ishin temat kryesore për të cilat u diskutua.



Në këtë takim, ligjërata kryesore, u mbajt nga ish kreu i OSBE-së në Shqipëri z. Bernd Borchardt, i cili ka studiuar nga pikëpamja historike dhe dokumentare se si shqiptarët historikisht dhe kryesisht gjatë Luftës së Dytë Botërore mikpritën, strehuan dhe nuk i dorëzuan hebrenjtë tek nazistët.

Kryetarja e Autoritetit Znj.Gentiana Sula vendosi theksin tek përcaktimi i disa piketave në programet e kujtesës në kurrikulat mësimore.

Ne shohim paralele me historinë tragjike të

hebrenjeve, me mënyrën se si u trajtuan njerëzit gjatë periudhës jotolerante, me ideologji ekstreme gjatë periudhës së komunizmit. Ajo që mësojmë nga holokausti, është se si disa institucione mundet me gjithë qëllimet e mira të degradojnë, duke sulmuar qytetarët e vet. Kjo në fakt është një ngjarje që ne na tingëllon familjare.”

Në përfundim, kryetarja Sula falënderoi mësuesit e historisë dhe pedagogët, dhe e konsideroi këtë konferencë si një hap i parë me punën edukative me të rinjtë.

Historianët kanë arritur në përfundimin se gjatë periudhës së Luftës së Dytë Botërore, në Shqipëri nuk janë evidentuar akte viktimizimi, dëbimi dhe as bashkëpunimi me nazistët kundra hebrenjve. Në atë kohë vetë Shqipëria ishte pushtuar nga nazistët dhe qeverisej nga administrata shqiptare e ngritur gjatë luftës, e cila refuzoi të jepte listat e hebrenjve në vend. Shqiptarët, myslimanë e të krishterë nuk dorëzuan asnjë hebre tek autoritetet e pushtimit dhe shpesh i mbrojtën ata duke rrezikuar dhe jetën e tyre.

Gazetari Ilir Vata, i cili është njohur me dokumente që ish-Sigurimi i Shtetit ka krijuar ndër vite tha se: “Përndjekja, survejimi, detyrimi për bashkëpunim i izraelitëve në Shqipëri, ishte karakteristikë e regjimit komunist, survejimi, detyrimi për bashkëpunim i izraelitëve në Shqipëri, ishte karakteristikë e regjimit komunist. Metodat që ndiqte Sigurimi i Shtetit ishin praktika të zakonshme si edhe për të tjerë të huaj në Shqipëri, apo vetë shqiptarët. Një politikë që sheh kudo armiq, që është paranojake, që e sheh zgjidhjen tek asgjësimi dhe zhdukja e tjetrit. Duke hedhur dritë mbi të shkuarën ne mund të ndërtojmë të ardhmen të sigurt për brezat që vijnë pas, që regjimet të tilla despotike si diktatura komuniste të mos përsëriten më.”

Shkrimtari Marçel Hila zgjodhi të flasë nëpërmjet dëshmive të mbledhura dhe të publikuara në librin e tij “Rrufeja në shtëpinë e mikpritësit”, ku në qendër është familja me origjinë hebreje Rabinovitz e strehuar në Shqipëri. Sot, pas kaq vitesh, histori të tilla me mesazhe mirënjohje ndaj shqiptarëve rrëfohen ende nga familjet hebreje, të cilat gjetën shpresë dhe mbijetesë në një kohë kur fati ishte kundër tyre.



Gazetarja e mirënjohur Monika Stafa autore e librit “Hebrenjtë në Shqipëri”, e cila moderoi aktivitetin u shpreh se “Lufta e dytë botërore ishte një kapitull i turpshëm jo vetëm për Gjermaninë, por për të gjithë Europën që heshti dhe u kujtua të vepronte kur ishte tepër vonë. Dhe ende sot politikanët evropianë nuk kanë mësuar asgjë nga shkatërrimet e mëparshme të kontinentit”.

Për t’i shpjeguar auditorit, se si dashuria vjen njësh me mbijetesën, Felçita Jokohel, një dëshmitare hebreje, tregon se si mbijetoi

në një vend që nuk kishte shumë për të ofruar veçse mikpritjes dhe shpresës. Kujtimet e treguara në vetën e parë, të pasuruara me detaje dhe që përcjellin emocione personale, janë një burim unik njohurish për ato kohë, si dhe material i jashtëzakonshëm edukativ.

Simon Mirakaj, ish i përndjekur politik dhe ish Anëtar i Autoritetit, vuri në dukje aktet pozitive dhe shumë domethënëse që administrata e kohës së luftës kreu për shpëtimin e hebrenjve nga nazistët.

“Kjo datë të vë përpara kujtesës dhe ideologjive të çmendura që shkaktuan këtë plagë tek hebrenjtë dhe mbarë njerëzimi. Ne akoma na ka zënë era e rëndë e qymyrit të komunizmit Shtrojmë pyetjen: Kush janë këta njerëz që i shpëtuan? Ne akoma kemi frikë të vdekurit. Përmend këtu aktin e Kadri Cakranit, që strehoi 200 hebrenj gjatë luftës në pronat e tij, Kolë Bibë Mirakës, Mustafa Krujës, Eqerem Bej Libohovës, Zef Kadarjen, që nuk i dorëzuan hebrenjtë tek pushtuesi, i strehuan dhe iu dhanë pasaporta vendase.”

Prof. Aljula Lubani, foli për vendin që zë trajtimi i temës së komunizmit në orët mësimore të lëndës së historisë dhe edukimit qytetar si dhe për projektet e reja që Autoriteti po planifikon të zhvillojë me ta në drejtim pasurimit me tekste mësimore për periudhën historike 1944-1991.

“Ne nuk mund ta lëmë mësuesin pa i ndihmuar. Së pari duhen ndryshime ligjore për arsimin parauniversitar,

të cilat më pas duhet të trasmetohen në kornizën kurrikulare dhe në gjykimin tim çdo program lëndor duhet të ketë një objektivi të veçantë, dedikuar edukimit të krimeve të komunizmit.

Në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, si dhe shoqatën e mësuesve të historisë, “Rinia dhe Historia”, drejtuar nga Vojsava Kumbulla, aktiviteti u ndoq nga mësues të historisë dhe edukimit qytetar, studentë të historisë, shkencave sociale e juridike.

Institucionet tona janë angazhuar në realizimin e projekteve të përbashkëta në drejtim edukimit të brezave të rinj mbi ngjarje të së shkuarës sonë komuniste. Partneriteti me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në lidhje me trajnimin e mësuesve të historisë, është në hapat e parë, si fillim me ndryshimin e narrativës së komunizmit me Luftën e Dytë Botërore dhe futjes në tekstet e historisë të temës së holokaustit.

Trajtimi i Holokaustit vazhdon të mbetet sfidë e shoqërisë së sotme kudo në botë, por për Shqipërinë ky rast merr një ngjyrim të veçantë. Shqipëria dhe shqiptarët me qëndrimin e tyre të vendosur për t’i fshehur hebrejtë e rrezikuar prej shfarosjes së madhe tregoi shumë.

Një popull i vogël, i kërcënuar nga ambiciet e fqinjëve për territore, nuk qëndroi indiferent, i mbrojti hebrejtë, ndaj dhe këtë tregim Autoriteti, historianët, edukatorët synojnë t’ia përcjellin brezave nëpërmjet teksteve shkollore, aktiviteteve përkujtuese, dëshmimeve dhe formave të tjera, njohëse dhe edukative.

PJESËMARRJE NË KONFERENCËN: “POLITIKA E KUJTESËS SI NJË ARMË: PERSPEKTIVA PËR LUFTËN E RUSISË KUNDËR UKRAINËS TANI ËSHTË HAPUR!”



Më 9 shkurt 2023 Autoriteti për Informim mbi Dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit, përfaqësuar nga anëtarët z. Albert Nikolla dhe z. Gjergj Marku, mori pjesë në konferencën dy ditore me temë: “Politika e kujtesës si një armë: Perspektiva për luftën e Rusisë kundër Ukrainës tani është hapur!” organizuar nga ENRS (Rrjeti Ndërkombëtar i Kujtesës) dhe Instituti Federal për Kulturën dhe Historinë e Gjermanëve në Evropën Lindore në bashkëpunim me Qendrën e Dokumentacionit për Zhvendosje, Dëbim, Pajtim në Berlin.

Konferenca shqyrtoi mekanizmat dhe metodat e përdorura në zbatimin politik dhe social të dezinformative historike dhe portretizimin e armikut, dhe diskutoi mënyrat se si këto mund të parandalohen ose zbuten.

PREZANTOHET PLATFORMA DIGJITALE : “TË MËSOJMË MBI TË SHKUARËN – BURIME ARSIMORE TË HAPURA 1944-1991”

EKSPOZITË DOKUMENTARE, LËVIZJET DEMOKRATIKE NË SYRIN E ISH-SIGURIMIT TË SHQETIT



Tiranë 20 shkurt 2023 - Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve, Agjencinë Telegrafike Shqiptare, Radio Televizionin Shqiptar si dhe Agjensinë e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP), organizoi një ekspozitë arkivore me dokumente të ish- Sigurimit të Shtetit mbi lëvizjet demokratike 1990-1991, foto dhe video si dhe prezantoi projektin e platformës digjitale “Të mësojmë mbi të shkuarën - burime arsimore të hapura,1944-1991”, një platformë e hapur për profesionistët e arsimit parauniversitar.

Aktiviteti, i mbajtur në kuadër të 20 Shkurtit 1991, ditë e kujtesës kombëtare, që shënoi ndryshimin rrënjësor të sistemit politik në vend, u zhvillua me praninë e protagonistëve të ngjarjeve deputetëve të komisionit të sigurisë, edukimit dhe ligjeve, bashkësisë së studiuesve, historianëve, grupeve të interesit, profesionistëve të arsimit dhe të rinjve, si dhe Ministres së Arsimit dhe Sportit, znj. Evis Kushi.

Të pranishmit fillimisht u njohën me kolanën prej 70 dosjesh voluminoze nga arkivi i Autoritetit, në të cilat përshkruhen ngjarjet më të rëndësishme që shoqëruan Shqipërinë menjëherë pas rënies së Murit të Berlinit, rritjen e revoltës popullore por edhe psikologjinë e regjimit diktatorial, shtypjen dhe dhunën që aplikoi edhe pse ishte në vitin e fundit të jetës së tij.

Mes tyre veçojmë : “Për zbulimin e parandalimin e një grupi me veprimtari armiqësore, Shkodër”, “Mbi ngjarjet e ndodhura në qytetin e Kavajës”, “Për disa fletushka që bëjnë thirrje për demonstratë dhe nxitje të mëtejshme të trazirave në Durrës etj”, “Informacion për ndjekjen në rrugë operative të demonstratës së heshtur në datën 28.1.1990 në Tiranë, problemi i centralizuar “Pseudodemokratët”, “Informacione për përpjekjen për rrëzimin me dinamit të monumentit të Enver Hoxhës në Shkodër”, “Për disa të dhëna mbi reagimet e komentet për krijimin e Partisë Demokratike dhe rreth situatës aktuale”, “Për disa të dhëna, probleme shqetësuese e komente negative në shkollën e bashkuar të oficerëve “Enver Hoxha” etj

Kryetarja e Autoritetit, Dr. Gentiana Sula, pjesëmarrëse e grevës së urisë së Studentëve në shkurt të vitit 1991 u shpreh se: Në këtë ditë të rëndësishme për lirinë e shqiptarëve është edhe momenti më i mirë të reflektojmë jo thjesht për atë cfarë ka kaluar nën regjimin komunist shqiptarët , por cfarë kemi bërë dhe duhet të bëjmë që komunizmi të njihet nga ata që nuk e përjetuan atë, gjenerata e re. Ajo kohë dhe ai mundim nuk duhet të tretet tek gjërat e harruara pasi është thjesht kujtim,por një mekanizëm kundër njeriut, shoqërisë dhe jetës së lirë.

Fotografia, historia, dosjet, shënimet, ngjarjet duhet të risjellin atë që ka ndodhur sicc ka ndodhur për shkak të nevojës për një demokraci të sigurtë që sfidon përpjekjet për rikthim në forma të reja jo më të një komunizmi shtypës, por të një autokracie monopolisteqë asfikson lirinë dhe demokracinë e qytetarëve.



Nuk kishte mënyrë më të mirë për të përkujtuar 20-shkurtin, ditën e rrëzimit të monumentit të diktatorit Hoxha, se sa ky takim brezash mes protagonistëve dhe pëfaqësuesve të Kuvendit, nën përkushtimin e udhëheqësisë dhe profesionistëve të arsimit, për të revolucionarizuar të mësuarit e të shkuarës sonë jo të largët.

Të pranishmit dëgjuan më pas dëshmitë e disa prej protagonistëve të atyre ngjarjeve dramatike.

Për auditorin e gjerë folën aktorja e mirënjohur Rajmonda Bulku, regjisori Kujtim Çashku, ish-drejtues i Policisë së Shtetit Mit'hat Havari, Edmon Vrapit, Akile Tasi, Sajmir Maloku, Mallëngjimi Skënderaj, Rexhep Ru-

geja, etj të cilët sollën perjetimet e tyre të asaj kohe dhe vunë theksin tek nevoja e shoqërisë për të qartësuar historisë, për të treguar mbi atë regjim sistematik shtypës, i cili u ndal vetëm përmes një përpjekje të vazhdueshme shumëvjeçare dhe nën frymën e ndryshimeve antikomuniste në Evropën Lindore dhe Qëndrore.

Aktorja e njohur Rajmonda Bulku, e cila iu bashkua lëvizjes studentore, sjell në kujtesën e saj 20 shkurtin si një eksperiencë e përjetuar duke e komentuar atë moment historik si një akt sublim për të siguruar lirinë e fëmijëve. “Në atë moment të gjithë ndodheshin në Tiranë, edhe prindërit e studentëve, pavarësisht pikëpamjeve të tyre ata ishin aty për të mbështetur fëmijët. Ishte diktaturë, mund të vrisnin, mund të futnin në burg. Megjithatë isha nënë e re me dy fëmijë të vegjël, nuk mund të rrija indiferente, prapa atyre të rinjve të guximshëm që na mësuari për herë të parë hapur se duhej luftuar dhe fituar. Me shumë përpjekje jemi këtu ku jemi me arritje dhe pikëpyetje të mëdha, por në fund të fundit atë ditë i dhamë një shpresë jetës sonë, të rinjve tanë që duhet të përipiqen për veten e tyre dhe për Shqipërinë tonë.”

Mit'hat Havari, pjesëmarrës në protestën e 14 shkurtit 1990 në Elbasan: “Ishim aty për problemet ekonomike, por kryesorja ne ishim aty për lirinë. Ajo ishte një demonstratë antikomuniste, jo protestë, të rinjtë brohorisnin: “Poshtë diktatura. !” “Poshtë Nexhmije Hoxha!” “Poshtë komunizmi !” Ishte një zgjim nga një gjumë letargjik.”

Kujtim Çashku, një nga intelektualët që iu bashkua protestave studentore: “Duhet pasur shumë kujdes se krimi që kryhet përmes përbaltjes së përditshme, rëndon së tepërmi jo vetëm jetët e njerëzve që vijnë nga inerci të caktuara post- totalitare, por edhe mbi fëmijët. E përshëndes këtë iniciativë për të inkuadruar në kurrikulat shkollore këto tematika, pasi synon ti rrisë të rinjtë me anë të dokumentacionit.”

Rexhep Rugeja, një nga protestuesit e revoltës që u mbajt në stadiumin e Kavajës, në 25 mars të vitit 1990, mes të tjerash tha : “Kujtimet e asaj dite janë të forta dhe të dhimbshme. Ishte dita kur morëm guximin të kundërshtonim regjimin ndaj jetët e sakrifikuara për demokraci nuk duhen harruar.” Aktiviteti vijoi me prezantimin e projektit të platformës digjitale “Të mësojmë mbi të shkuarën – burime mësimore të hapura , 1944- 1991,” krijimi i të cilës vjen si nevojë e shoqërisë për t’u njohur më thellë dhe më drejt me pasojat që sjellin regjimet komuniste duke vënë theksin te nevoja për të sfiduar historiografinë e njëanshme, burimet e censuruara, kohën që rrjedh për të siguruar rrugën europiane që kërkon një rini të qartë për kostot e diktaturës komuniste.

Ministrja e Arsimit dhe e Sporteve, Evis Kushi tha me këtë rast : “Një komb që harron të kaluarën e tij nuk ka të ardhme, ndaj kujtesa është shumë e rëndësishme për ngjarje si 20 shkurti e të tjera që lidhen me komunizmin. Kujtesa na ndihmon që një ngjarje të tilla të mos përsëriten. Të rinjtë tanë nuk i kanë përjetuar ato ngjarje . Ata duhe t’i dinë , t’i njohin ndaj ne na lind detyra dhe përgjegjësia që t’u tregojmë të vërtetën, t’u tregojmë historinë. ”

Prof Alijula Lubani, eksperte për arsimin, prezantoi analizën e kurrikulës së Arsimit Parauniversitar, mbi pasqyrimin në të për periudhën 1944-1991

Pas këtij prezantimi, në mbështetje të saj erdhën prononcimet e deputetëve të Kuvendit Popullor.

Znj.Klotila Bushka, Kryetare e Komisionit Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, tha : “Sot dëgjojmë shumë vesione të së vërtetës, por duhet të kemi një të vërtetë dëgjojmë shumë version të së vërtetës, por duhet të kemi një të vërtetë e cila vjen në bazë të një thellimi të thelluar, në bazë të fakteve të verifikuara dhe të certifikuara. Duhet të flasim ekspertë , dokumnetet në mënyrë që njerëzit të jenë të artë se cfarë ka ndodhur, jo vetëm që brezat që vijnë që s’kanë lidhje fare me atë system dhe u duket ccudi ajo që u tregojmë, por dhe ata që janë, që e kanë kaluar atë sistem, për të kuptuar sesi natyra njerëzore pavarësisht parimeve që përgjithësisht i përqafojmë, e vërteta është në luftë me errësorën dhe nëse nuk kuptohet e vërteta ka shance të përsëritet.”

Synimi i platformës është ndihma ndaj profesionistëve të arsimit e sidomos mësuesve që të amendojnë mësimdhënien e historisë, gjuhës e letërsisë dhe edukimit qytetar e filozofisë, duke përdorur mjetet ilustruese të besueshme dhe tërheqëse, aktuale dhe relevante.

Platforma do të jetë web-based dhe në bazë të standardeve të UNESCO-s për burimet e hapura arsimore si dhe do të bashkëpunojë fuqimisht me platformën @HI-Story.ensr Ndërkohë që kjo platforme digjitale po merr formë, kjo platforme nuk do të jetë e njëanshme, nuk do të jetë një formë propagande por dialogu; nuk do të jete statike por pjesëmarrëse, nuk do të jete vetëm lokale por europiane dhe globale, nuk do të tolerojë stereotipe, gjuhë urrejtje dhe mohim apo relativizëm të krimeve ndaj njerëzve, nuk do të tolerojë shkelje të të drejtave të autorit, pronësinë intelektuale dhe privatësinë.



Nisma e Autoritetit për ndërtimin e platformës digjitale vjen në kuadër të plotësimit të pikave të marrëveshjes ndërinstitucionale të lidhur me Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve, nënshkruar më datë 18.03.2021, e cila ka parashikuar përfshirjen në kurrikulat shkollore të ngjarjeve që lidhen me ditët e kujtesës e figura historike që kanë lidhje me to.

Nisma e Autoritetit për ndërtimin e platformës digjitale vjen në kuadër të plotësimit të pikave të marrëveshjes ndërinstitucionale të lidhur me Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve, nënshkruar më datë 18.03.2021, e cila ka parashikuar përfshirjen në kurrikulat shkollore të ngjarjeve që lidhen me ditët e kujtesës e figura historike që kanë lidhje me to.


Në këtë nismë Autoriteti ka kërkuar dhe gjetur bashkëpunimin e Agjencinë Telegrafike Shqiptare, Radio Televizionin Shqiptar të cilët do të kontribuojnë me dokumentet, foto dhe filmime që janë krijuar gjatë kohës së regjimit komunist nga burime zyrtare. Këto burime, ndër të cilat, dokumente arkivor, artikuj, filmime dhe foto do të inkuadrohen në këtë platformë digjitale, e cila do të shërbejë profesionistëve në njohjen dhe studimin e ngjarjeve që shenjuan historinë e Shqipërisë prej vitit 1944 deri në vitin 1991.



“ MENDJE TË BUKURA, SHPIRTRA TË LIRË ”

Më datë 27 shkurt 2023 mbështetur nga Autoriteti për informim mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, në sallën “Unesco” e Muzeut Historik Kombtar u shfaq shfaqja “ Mendje të bukura, shpirtra të lirë ”, me autore Rovena Rozhanin dhe regji të Suela Bakos, në të cilën nxënës të gjimnazit «Andon Zako Çajupi» dhe gjimnazit «Qemal Stafa rijetësuan tri shkencëtare: Sabiha Kasimati, Mari Kyri dhe Rozalinda Frenklin, të cilat jetuan në kohë e vende të ndryshme dhe dhanë kontribut të vyer në shkencë.

Aktiviteti u realizua në kujtim të ditës tragjike, të 19 shkurtit 1951 kur do t’u merrej jeta 22 intelektualëve, të akuzuar se kishin hedhur një sasi dinamiti në oborrin e ndërtesës së Ambasadës Sovjetike, ndër të cilët Sabiha Kasimati, nismëtare e themelimit të Muzeut të Shkencave të Natyrës, u ekzekutua së bashku me 21 persona të tjerë mesnatën e 26 shkurtit të vitit 1951.



**AUTORITETI PER INFORMIMIN MBI
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TE SHTETIT**

Adresa: Njësia Administrative nr. 4
Rruga e Dibrës, garnizoni "Skënderbej", Tiranë